

në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit, nën kërcënimin e përmbarimin të detyrueshëm.

Kundër këtij vendimi, palët në procedurë kanë parashtruar ankesë:

Zyra e Prokurorit Disiplinor ka parashtruar ankesë me nr.2-3-1/22 me datë 06.10.2023, duke konsideruar se gjoba është e ulët sepse në rastin konkret nuk janë marrë parasysh mjaftueshëm rrethanat rënduese se i paraqituri është përsëritës i shkeljes disiplinore të natyrës së njejtë, fakt ky i vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.630/2023 të datës 20.09.2023, ku ka mbetur në fuqi Vendimi i formës së prerë V.KA.nr.18-14/22 i datës 02.06.2023, me të cilin vendim të paraqiturit i është shqiptuar gjobë në lartësi prej 2,000.00€ (dymijë euro). Si dhe rrethana tjetër rënduese që i paraqituri është bartës i pozitës vendim-marrëse, e ka të njohur normativën e OAK-së dhe do të duhej të promovonte shembull të mirë etik. Rrjedhimisht, Zyra e Prokurorit Disiplinor ka propozuar që Vendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të arrihet qëllimi i procedurës disiplinore dhe i paraqituri të mos përsëris shkelje disiplinore që cenojnë imazhin e avokatisë.

Ushtuesi i fletëparaqitjes Avokat _____, ka parashtruar përgjigje në ankesën e Prokurorit Disiplinor me nr.2-3-4/23 me datë 30.10.2023, duke konsideruar se gjoba e shqiptuar është tejet e ulët dhe joproporcionale në raport me nivelin e dashjes së të paraqiturit, sjelljet e tij paraprake, të mirat e rrezikuara siç janë dëmtimi i imazhit dhe prestigjit të avokatisë. Me ç' rast ka propozuar që ankesa e Prokurorit Disiplinor të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Vendimi i ankimuar duke i shqiptuar të paraqiturit masën disiplinore humbja e të drejtës së ushtrimit të avokatisë për periudhën 6 muaj.

I paraqituri Avokat _____, ka parashtruar ankesë me nr.2-3-3/22 me datë 30.10.2023, duke konsideruar se Komisioni Disiplinor nuk ka trajtuar pretendimin e tij për përjashtimin e Prokurorit Disiplinor Rexhep Veseli, e si rrjedhojë këtë kërkesë të tij nuk e ka trajtuar as Këshilli Drejtues i OAK-së. Më tutje thekson se në lidhje me këtë çështje ka parashtruar padi në gjykatën kompetente. Duke propozuar që ankesa e tij të aprovohet, dhe Vendimi i ankimuar të anulohet si i kundërligjshëm dhe çështja të kthehet në rishqyrtim. Ndër të tjera, i paraqituri në ankesën e tij në paragrafin e fundit të ankesës ka parafrazuar se refuzon kategorikisht që kjo ankesë e tij të shqyrtohet nga anëtarët e shkallës së dytë, respektivisht Avokatët Daut Rudi, Edona Sina, Kadri Sylaj, Drenusha Berisha dhe Shpetim Sadiku.

Zyra e Prokurorit Disiplinor ka parashtruar përgjigje në ankesën e parashtruar nga i paraqituri me nr.2-3-5/22 me datë 01.11.2023, duke kundër-argumentuar në lidhje me përjashtimin e Prokurorit Disiplinor Rexhep Veseli, duke bashkangjitur Vendimin e Këshillit Drejtues 725/2023 i datës 17.08.2023, të cilin vendim i paraqituri e ka pranuar me datë 14.09.2023 sipas fletë-kthesës postare, me të cilin vendim të paraqiturit i është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Prokurorit Rexhep Veseli.

Komisioni i Ankesave vlerësoi afatshmërinë e ankesave dhe përgjigjes në ankesa, ku në bazë të shkresave të lëndës ka rezultuar që të gjitha janë parashtruar brenda afatit.

Para se Komisioni i Ankesave të lëshohet në trajtimin e pretendimeve në ankesat e palëve, me prioritet ka trajtuar pretendimin nga ana e të paraqiturit në lidhje me refuzimin e tij që ankesa e tij të trajtohet nga Avokatët Daut Rudi, Edona Sina, Kadri Sylaj, Drenusha Berisha dhe Shpetim Sadiku. Në këtë drejtim ky Kolegj konstaton se në shkresa të lëndës nuk ka asnjë kërkesë zyrtare të veçantë dhe të arsyetuar nga i paraqituri në lidhje me përjashtimin e emrave të lartcekur, siç e përcakton neni 18 i Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë. Për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit të Ankesave vendos Kryetari i Komisionit të Ankesave, në rastin konkret do të duhej të vendos Avokat Daut Rudi, e për përjashtimin e kryetarit vendosin anëtarët. Mirëpo i paraqituri ka përfshirë edhe emrin e kryetarit, edhe emrat e shumicës së anëtarëve të Komisionit si shkallë e dytë. Tutje ky Kolegj konstaton se, Komisioni i Ankesave nuk i nënshtrohet asnjë organi tjetër mbikëqyrës brenda OAK-së, është organ krejtësisht i pavarur që nxjerrë aktin përfundimtar administrativ, dhe si i tillë çështja e përjashtimit të mëtujujshëm të kryetarit së bashku me shumicën e anëtarëve të tjerë nuk është e paraparë me asnjë normativë. Për më tepër, ky pretendim nga ana e të paraqiturit nuk përmban asnjë arsye të qartë dhe të qëndrueshme që do të argumentonte paanshmërinë eventuale të këtij Kolegji, i njëjti është parashtruar vetëm me qëllim të prolongimit të procedurës që çështja të arrin afatin e parashkrimit absolut. Andaj, kolegji unanimisht konstaton që ky pretendim nuk është i lejuar e as i bazuar.

Më tutje, pas analizimit të të gjitha pretendimeve të parashtruara nga palët në procedurë, Komisioni i Ankesave vlerësoi se: **ankesa e ushtruar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor është e bazuar.**

Komisioni Disiplinor si shkallë e parë ka vërtetuar në mënyrë jo të plotë faktet në lidhje me matjen e lartësisë së masës disiplinore, duke vepruar përkitazi me procedurën penale do të duhej të merrej parasysh minimumin dhe maksimumin i paraparë i gjobës për shkelje të natyrës së rëndë. Në bazë të nenit 123 të Statutit të OAK-së minimumi i gjobës për shkelje të rënda është 500€ (pesëqind euro), ndërsa maksimumi është 5,000€ (pesëmijë euro), në vendimin e shkallës së parë mungon arsyetimi pse është shqiptuar minimumi i paraparë, kur në rastin konkret është gjetur asnjë rrethanë lehtësuese. Komisioni i shkallës së parë është dashur të i jep peshën e duhur rrethanave rënduese siç janë: qëndrimi dhe qasja jokorrekte ndaj gjithë organeve të OAK gjatë zhvillimit të kësaj procedure (dhe proceseve të tjera), duke përfshirë edhe emra të avokatëve nga Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave. Tendenca e të paraqiturit kinse për të ushtruar një lloj presioni brenda OAK-së duke shprehur paknaqësitë e tij qoftë me kallxime penale, me padi në gjykatë, apo me e-maila të gjatë akuzues, nuk do të duhej të zbrapsin Komisionin e shkallës së parë që të gjykoj drejtë dhe në bazë të normativës së OAK-së, e kurrësi të favorizojnë apo të rëndojnë dikë më shumë se sa e lejon normativa e OAK-së. I paraqituri në një rast tjetër disiplinor, është përgjegjës me vendim të formës së prerë ku i është shqiptuar gjobë në lartësi prej 2,000€ (dymijë euro) për shkelje të rëndë disiplinore, kjo vërtetuar edhe me vendim gjyqësor të plotfuqishëm AA.nr.630/2023 të datës 20.09.2023, që do të thotë kemi të bëjmë me një përsëritës të shkeljeve disiplinore. I paraqituri është bartës i një pozite vendim-marrëse brenda OAK-së, e ka të njohur normativen e OAK-së, dhe do të

duhej të promovonte shembull etik tek të gjithë avokatët e tjerë, te institucionet dhe mbarë shoqëria, si dhe i njejti asnjëherë nuk shpreh pendesën e tij. Kur kemi të bëjmë me raportin avokat-avokat, shkeljet e tilla nuk duhen të tolerohen, sepse raporti mes avokatëve është pasqyre se si na shohin të tjerët neve. Mënyra e komunikimit që ka zgjedhur i paraqituri nuk është aspak profesionale dhe dëmton imazhin e gjithë avokatisë. Prestigji i avokatisë dëmtohet kur vetë avokatët zgjedhin gjuhën e ofendimeve publike, e kur kjo ndodhë atëherë sigurisht që do të humb edhe respekti nga të tjerët ndaj profesionit tonë. Andaj edhe masat disiplinore për shkelje të tilla disiplinore duhet të ashpërsohen që të arrihet qëllimi i procedurës disiplinore.

Në lidhje me pretendimet e të paraqiturit në ankesë, Kolegji i konsideron që të gjitha si të pabazuara. Vetë i paraqituri në ankesë thirret vetëm në çështjen e përjashtimit të Prokurorit Disiplinor Rexhep Veseli (pa u lëshuar më tutje). Kolegji konstaton se në lidhje me këtë ka vendosur Këshilli Drejtues – si organ kompetent me vendimin nr.725/2023 të datës 18.08.2023. Për më tutje i paraqituri çështjen e ka vazhduar me padi në gjykatën kompetente, mirëpo parashtimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit Drejtues, rrjedhimisht Kolegji shqyrtues nuk ka gjetur asnjë pengesë procedurale në këtë drejtim. Në lidhje me materialin e bashkangjitur në ankesë siç janë e-maillet, materiale nga portalet informuese, vendime të ndryshme të OAK-së, vendime procedurale nga një rast penal gjyqësor, parashtesat e komunikimeve ndër institucionale etj, që të gjitha janë irrelevante, nuk bien në domenin e trajtimit të kësaj çështje disiplinore, dhe si të tilla nuk kanë asnjë fuqi provuese për një vendim ndryshe.

Sa i përket parashtimeve të ushtruesit të fletëparaqitjes në përgjigjen e tij në ankesë të prokurorit, në lidhje me propozimin e tij që të paraqiturit të i shqiptohet masa disiplinore ndalimi i ushtrimit të avokatisë në periudhë 6 mujore, Kolegji e konsideron si masë shumë e rëndë që nuk përkon me rrethanat në rastin konkret, por që me shqiptimin e gjobës në lartësi sikur në dispozitiv të këtij Vendimi do të arrihet qëllimi i kësaj procedure disiplinore.

Andaj mbështetur në arsyet e lartcekura, Komisioni i Ankesave si shkallë e dytë, në bazë të nenit 110 par.1 dhe par.2 të Statutit të OAK-së, si dhe në bazë të nenit 46 par.1 pika 1.3, neni 46 par. 2, neni 51 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë, vendosi sikur në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

PRISHTINË, V.KA.nr.2-3-7/2022, datë 13.11.2023

Kryesuesja,

Avokate Edona Sina,



Vendimi i Komisionit të Ankesave është i formës së prerë, kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.